



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE**

**VENDIM**

**NR. 16, DATË 23 / 07 / 2024**

**PËR MOSPRANIM TË KËRKESËS PËR PËRFITIM TË STATUSIT**  
**“INVESTIM/INVESTITOR STRATEGJIK PROCEDURË E VEÇANTË” PËR**  
**PROJEKTIN E INVESTIMIT “RODON SHORES” ME SUBJEKT APLIKUES**  
**RODON GROUP SHPK, NUIS M31914003A**

Në mbështetje të Nenit 9, nenit 13 dhe nenit 17 pika 5 të Ligjit Nr. 55/2015, “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë”, Kreu I, pika 3/c të VKM-së Nr. 1023, datë 16.12.2015 “Për Nënsektorët Strategjikë dhe Zonat me Përparësi Zhvillimi” dhe Kreut II, pika 8, 10 e VKM-së Nr. 1026, datë 16.12.2015 “Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike”, Komiteti i Investimeve Strategjike, me propozim të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA),

**VLERËSOI:**

- Projekti i investimit parashikon zhvillimin e një resorti turistik, i cili konsiston në ndërtimin e disa hoteleve, vilave dhe apartamenteve së bashku me ambiente shërbimi, si edhe restorante. Projekti përfshin dhe një pistë helikopteri, një kulle vrojtimi dhe një mol me kapacitet ankorimi 30 mjete lundruese, si dhe zhvillimin e një parku me struktura të përkohshme.
- Vlera e investimit për projektin e propozuar parashikohet të jetë 210.569.670 Euro (dyqind e dhjetë milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e shtatë dhjetë) Euro dhe numri i të punësuarve parashikohet të jetë 170 punonjës.
- Projekti do të realizohet në një sipërfaqe totale zhvillimi prej afërsisht 138.5 ha, dhe sipërfaqe totale ndërtimi prej 29.5 ha, pronë shtetërore, ZK 3365 fshati Shetaj, Bashkia Durrës.

- Projekti realizohet nga subjekti Rodon Group shpk me NUIS M31914003A.
- Në përfundim, pasi u njoh me gjithë dokumentacionin e nevojshëm,

## **KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE**

### **VENDOSI:**

1. Mospranimin e kërkesës për përfshirjen e projektit investues “Rodon Shores”, me subjekt investues Rodon Group shpk NIPT M31914003A, ZK 3365, Bashkia Durrës në procedurën e veçantë dhe mbështetjen që ofron ky status.
2. Projekti në pjesën më të madhe të tij nuk përfshin komponentë që i përkasin sektorit të turizmit si hotel, vila në funksion të hotelit, ambiente shërbimi, bare e restorante, si edhe shërbime të tjera relaksi e rekreacionit, por më së shumti përfshin zhvillimin e rezidencave dhe apartamenteve të banimit.
3. Vendimi i Komitetit të Investimeve Strategjike publikohet dhe regjistrohet në Regjistrin e Investimeve Strategjike dhe i njoftohet investitorit nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, në rolin e saj të Sekretariatit të Komitetit të Investimeve Strategjike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KRYETAR I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE**

### **KRYEMINISTËR**

**EDI RAMA**

### **ZËVENDËSKRYEMINISTËR**

### **MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**

**BELINDA BALLUKU**

**MINISTËR I EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT**

BLENDI GONXHJA

**MINISTËR I FINANCAVE**

ERVIN METE

**MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT**

MIRELA KUMBARO

**MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL**

ANILA DENAJ

**AVOKATI I PËRGJITHSHËM I SHTETIT**

ODISE MOÇKA

**SEKRETARIATI TEKNIK I KIS**

LAURA PLAKU (SARO)